Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.1 dhe 12.2 shkronja d), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040"Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28 e datës 04.06.2008, nenit 26 pika 3, të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5 të dt.31.10.2019, sipas nenit 6 pika 1.6 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.28.09.2023, bie këtë:

V E N D I M

PËR VËNIEN NË KONSULTIM PUBLIK TË DRAFT – PLANIT KOMUNAL PËR BARAZI GJINORE 2023-2027

I.

Miratohet Vendimi për vënien në Konsultim Publik të Draft-Planit Komunal për Barazi Gjinore 2023-2027.

II.

Vënia në Diskutim Publik e Draft-Planit Komunal për Barazi Gjinore 2023-2027, bëhet me qëllimin e dhënies së kontributit nga Institucionet, ekspertët e fushës përkatëse, grupet e interesit dhe qytetarët, në mënyrë që Plani të jetë sa më funksional për subjektet implementuese dhe të tjerët.

III.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit, si dhe publikimit në ueb faqen e Komunës.

IV.

Vendimi bëhet transparent përmes publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës,Tabelës së shpalljeve dhe Zyrës për Informim të Komunës së Deçanit.

01.Nr.VIII-5
Deçan,dt.28.09.2023

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ

KK Deçan Nr. 34628
01 06.10.23

Në bazë të Qarkores buxhetore 2024/02, në bazë të nenit 40 paragrafi 40.2 shkronja (b) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr.28/2008), nenit 26 pika 2 të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, dt.31.10.2019 , Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.28.09.2023, me 14 vota "për" dhe 11"kundër", merr këtë:

V E N D I M

MBI APROVIMIN E BUXHETIT PËR VITET 2024-2026

I.

Aprovohet buxheti i Komunës së Deçanit për vitet 2024-2026, sipas Qarkores buxhetore 2024/02.

II.

Buxheti për vitin fiskal 2024, 2025 dhe 2026, paraqitur si në tabelën në vazhdim:

	Viti 2024	**Viti 2025**	**Viti 2026**
G. Përgjithshëm	6,225,958.00	6,690,087.62	7,126,185.00
G.S.Arsimi	4,611,056.00	4,749,387.38	4,891,869.00
G.S.SHëndetësisë	1,635,185.00	1,716,944.00	1,802,791.00
SH.REZIDENCALE	188,318.00	200,000.00	200,000.00
TOTAL GRANTI	**12,660,517.00**	**13,356,419.00**	**14,020,845.00**
T HV	847,565.00	872,716.00	909,876.00
TOTAL BUXHETI	**13,508,082.00**	**14,229,135.00**	**14,930,721.00**

III.

Të hyrat vetanake të pashpenzuara nga viti 2023 autorizohen të shpenzohen në vitin 2024, për destinimet për të cilat është bërë zotimi i tyre.

IV.

Të hyrat dhe shpenzimet e përgjithshme buxhetore të paraqitura në pjesën tabelore të cilat janë pjesë përbërëse e këtij Vendimi, autorizohen për vitin fiskal 2024, për vitin fiskal 2025 dhe për vitin fiskal 2026, për periudhën prej 01 Janar deri me 31 Dhjetor të vitit përkatës.

V.

Nuk mund të bëhen kurrfarë shpenzimesh apo detyrime financiare të cilat bijën ndesh me këtë vendim.

VI.

Mjetet e destinuara për paga dhe shtesa nuk mund të tejkalohen, e gjithashtu as numri i punëtorëve të paraparë nga BKK.

VII.

Pjesa tabelore e paraqitur në ANEXIN PCF-1, PCF-2, PCF-3 dhe PCF-4 dhe tabelat e projekteve kapitale si dhe PIP-at e të gjitha linjave buxhetore janë pjesë përbërëse të këtij Vendimi.

VIII.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

IX.

Me Vendim njoftohen:MF-Departamenti i buxheteve Komunale dhe organet kompetente të Komunës së Deçanit.

01.Nr.VIII-2
Deçan,dt.28.09.2023

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ

Kuvendi Komol 33729
01 29.09.23

Bazuar në Ligjin Nr.08/L-193 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023 /neni 16 paragrafi 1. (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës dt. 30 Dhjetor 2022), nenit 40 paragrafi 40.2 shkronja (b) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 "Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28 e datës 04.06.2008, dhe nenit 26 pika 2. të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, të datës 31.10.2019, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.28.09.2023, merr këtë:

V E N D I M

PËR RIALOKIM TË MJETEVE BUXHETORE NË KATEGORINË E INVESTIMEVE KAPITALE

I.

Merret Vendimi për Rialokim të mjeteve buxhetore në kategorinë e Investimeve Kapitale të vitit fiskal 2023, sipas të dhënave të prezantuara në vijim:

1. **Mjetet financiare për rialokim nga projekti ekzistues " Ndërtimi i fshatit turistik Laku i Kryqes, faza e II" me projekt kod 10/631/18015/32000/52838/045 në vlerë prej 100,000.00 €, grant i përgjithshëm, këto mjete (100,000.00 €) rialokohen në projektin ekzistues "Zgjerimi i ndriçimit efiçient publik nëpër fshatrat: Baballoq, Shaptej, Dubovik, Papiq, Maznik, Dashinoc" (ndriçimi publik i rrugëve) me projekt kod 10/631/18015/31510/53202/0451.**

II.

Për ekzekutimin e këtij vendimi do të kujdesen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Shërbime Publike të Komunës së Deçanit.

III.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

IV.

Me Vendim njoftohen:MF-Departamenti për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Arhivi i KK Deçan.

01.Nr.X-VIII/8
Deçan,dt.28.09.2023

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ

Kuvendi Komunal 337/25
01 29.09.23

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.1 dhe 12.2 shkronjat (d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040"Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28 e datës 04.06.2008, nenit 7 të Ligjit Nr.03/L-145 për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë (Gazeta Zyrtare e republikës së Kosovës e dt.05 Nëntor 2009), nenit 26 pika 3, të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5 të dt.31.10.2019, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.28.09.2023, bie këtë:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E PLANIT LOKAL TË VEPRIMIT RINOR 2023-2026

I.

Miratohet Plani Lokal i Veprimit Rinor 2023-2026.

II.

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është akti komunal me emërtimin, Plani Lokal i Veprimit Rinor 2023-2026.

III.

Për ekzekutimin e këtij Vendimi kujdeset Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sporte e Komunës së Deçanit.

IV.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

V.

Me Vendim njoftohen: MPL, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sporte dhe Arkivi i Komunës së Deçanit.

01.Nr.VIII-3
Deçan,dt.28.09.2023

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ

K.K.Deçan AS 34613
01 06.10.23

PLANI I VEPRIMIT RINOR LOKAL DEÇAN

2023 – 2026

Deçan, Shtator 2023

K.K Deçan As 34615
01 06.10.23

PLANI I VEPRIMIT RINOR LOKAL (2023-2026) DEÇAN

- ***Çfarë është PVRL-ja ?***

Plani i Veprimit i Këshillit të Veprimit Rinor Lokal Deçan nënkupton politikën lokale për rini për vitin 2023/2026. Kjo është strategji gjithëpërfshirëse për të rinjtë e Deçanit duke u bazuar në nevojat dhe pjesëmarrjen e të rinjve .

- ***Me çfarë ka të bëjë?***

Ka të bëjë me veprim, pjesëmarrje, arsimim, punësim, shëndetësi, ka të bëjë me shumicën e çështjeve dhe problemeve, me të cilat i riu i Deçanit ballafaqohet çdo ditë.

Plani i Veprimit Rinor Lokal Deçan synon që të përmirësoj gjendjen e të rinjve, duke përfshirë institucionet Lokale Qeveritare dhe jo Qeveritare në identifikimin dhe përmbushjen e nevojave të të rinjve duke gjetur mënyra dhe mekanizma për pjesëmarrjen e të rinjve në procesin e vendimmarrjes në qytetin e Deçanit.

Ky dokument bazohet në Strategjinë Kosovare dhe Planin e Veprimit për Rini që është dokument i Qeverisë së Republikës të Kosovës , i hartuar nga departamenti i Rinisë në **Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve** .

- ***Kush e hartoi atë në Deçan***

Plani i Veprimit Rinor Lokal në Deçan është dokument i hartuar nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e Kuvendit Komunal në Deçan dhe me kontributin e shumë aktivistëve të rinj, **si dhe financues i projektit Departamenti i Rinis ne Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve** .

Ky plan paraqet mënyrat e qasjes së politikave rinore komunale ndaj të rinjve dhe nevojave të të rinjve në qytetin e Deçanit.

- ***Çfarë mund të presin të rinjtë e Deçanit nga ky plan ?***

Plani i Veprimit Rinor Lokal Deçan është për të rinjtë e moshave 15 – 24 vjeç dhe çdo kush që i takon kësaj grup moshe do të përfitojë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, mirëpo pa përjashtuar moshë, racë, gjini të tjera të shoqërisë .

Në plan, në bazë të politikave rinore të Sektorit të Rinisë të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport pranë Kuvendit Komunal të Deçanit ekzistojnë numër i veprimeve në zonat rurale dhe urbane të Deçanit.

Plani i Veprimit Rinor Lokal Deçan promovon bashkëpunimin ndërmjet organizatave Rinore dhe Qeverisë Lokale dhe në të njëjtën kohë ndërlidhë politikat ndër-sektoriale në mes të drejtorive të ndryshme pranë Kuvendit Komunal të Deçanit, që ndërlidhet me të rinjtë në fushën e politikave dhe programeve rinore.

Ky plan mund të pasurohet edhe më tutje duke kontaktuar drejtpërdrejt Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport përkatësisht Sektorin e Rinisë.

PLANI I VEPRIMIT LOKAL RINOR (2023-2026) DEÇAN

- ***Themelimi i Këshillit i Veprimit Rinor Lokal në Deçan***

Pas fillimi të zbatimit të planit (duke filluar përgaditjet gjatë procedurës së hartimit të planit deri në miratimin e tij), Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sporte, do të angazhohet për Themelimin e Këshillit Lokal të Veprimit Rinor (KVRL) , në të cilin do të ftohen për konsultime dhe dhënie të kontributit të tyre shumë organizata jo qeveritare, si dhe grupet tjera formale siç janë ato të shkollave të Mesme të Deçanit.

Keshilli i veprimit Rinor Lokal do të perbehet nga perfaqsuesit e të gjitha OJQ-ve Lokale ku do të perzgjedhen delegatet nga ata perfaqsues qe mund te kontribuojnë direkt ne implementimin e këtij plani.

Strukturat KVRL-së,si vijon :

1. Kryetari i KVRL-së
2. Nënkryetari i KVRL-së
3. Tre anëtar të kryesisë
4. Këshilli duhet të përbëhet prej 7 antarësh te KVRL-së ne Deçan.

- ***Pse duhet të ekzistoj KVRL-ja***

Sepse rinia Deçanase ka pasur nevojë që të ketë një organ të vetin të organizuar për të ndikuar në vendim marrje dhe në të njëjtën kohë për të hulumtuar opinionin, gjendjen e rinisë, dhe të bashkoj organizata të ndryshme brenda një trupi me qëllim të plotësimit të nevojave të cekura më lart.

- ***Çka është KVRL-ja***

Këshilli Veprimit Rinor Lokal (KVRL) është mekanizëm nëpër mes të cilit rinia Deçanase mund t'i adresojë brengat, shqetësimet dhe rekomandimet e veta tek Kryetari i Komunës .

Pra Këshilli Veprimit Rinor Lokal është organ këshillë dhënës për rini i Kryetarit të Komunës e në të njëjtën kohë është edhe hulumtues i gjendjes së rinisë në Komunë, dhe mekanizëm me ndikim në procesin e vendim marrjes .

- ***A mund të marr pjesë***

Po, nëse jeni anëtar i ndonjë organizate jo qeveritare, apo i ndonjë grupi tjetër rinor të organizuar dhe jeni të moshës 15 – 24 vjeç. KVRL ka për detyrë që të mbaj Kuvende vjetore, në të cilat Kuvende mund të jeni pjesëmarrës i deleguar .

Po ashtu përmes projekteve të implementuara nga Këshilli Veprimit Rinor Lokal (KVRL) në çdo kohë dhe në çdo vend mund të jeni pjesë e tyre.

POLITIKAT E SEKTORIT TE RINISE SË DEÇANIT

Sektori i Rinisë ne kuadër të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport pran Kuvendit Komunal të Deçanit vepron në këto politika rinore:

- Stimulimi i talenteve te rinj apo te reja.

- Mbështetja e të rinjve nga zonat rurale në ide dhe projekte që vijnë prej tyre.
- Shkëmbimi i përvojave dhe informatave në mes te rinjve.
- Integrimi i të rinjve për brenda qytetit të Deçanit.
- Politika e punësimit të të rinjve.
- Edukimi shëndetësor dhe parandalimi i dukurive negative.
- Fuqizimi i rolit të rinisë në vendimmarrje.

Këto politika hartohen në koordinim të plotë në mesë shoqërisë civile dhe sektorit të rinisë në komunën e Deçanit.

FUQIZIMI I QENDRES RINORE

Qendra Rinore është vend ku te rinjtë e kanë si vend takim por edhe si vend ku mund të iniciohen dhe projektohen projektet e ndryshme me karakter rinor. Kjo qendër ka nevojë të fuqizohet më dy përgjegjës aktiv me qëllim që të jetë e hapur çdo ditë.

12 GUSHTI – DITA NDERKOMBETARE E RINISE

Në kuadër të ditës ndërkombëtare të rinisë në Deçan parashihen aktivitete gjithëpërfshirëse në qendrën rinore me ftesë të veçantë për të rinjtë që vijnë nga diaspora ku mund të përfshihen edhe sektori i Kulturës dhe Drejtoria e Arsimit.

SHËRBIMI PËR PAQE

Në kuadër të këtij projekti Shërbimit për Paqe organizuar me grupe rinore shumë etnike, është menduar puna vullnetare në qendra dhe pjesë të ndryshme të qytetit, siç janë: shtëpitë e shëndetit, çerdhet e fëmijëve, qendra strehimore, qendrat e kujdesit social, në të cilat këto grupe do ti ndihmonin në pastrimin e këtyre qendrave, organizimi i shënimit të datave ndërkombëtare dhe shtetërore.

AKTIVITETE KULTORORE (PIKTURE, MUZIKE , ART) 2023-2026

Në kuadër të këtyre aktiviteteve është menduar që të kemi projekte të ndryshme me karakter garues në tërë Deçanin, dhe jo vetëm të karakterit ndëretnik por edhe me gjerë.

SHENIMI I DITES NDERKOMBETARE TE AMBIENTIT 2023-2026

Dita ndërkombëtare e ambientit do të jetë njëra prej mundësive më të mëdha që të rinjtë apo të rejat të jenë më kreativ në shënimin e kësaj date, përmes programeve të ndryshme të ideuar nga vetë të rinjtë dhe të përkrahur nga Kuvendi Komunal, Qeveria e Kosovës dhe donatorë të tjerë.

SEMINARE 2023-2026

Seminar të ndryshme me tema të ndryshme do të jenë mundësi shtesë që të nxirren edhe rekomandime por edhe të plotësohet gjatë implementimit të planit veprues për rininë në Deçan.

MBESHTETJA E TË RINJEVE NGA ZONAT RURALE

KVRL do të mbështesë të rinjtë nga zonat rurale dhe do të bëjë rrjetëzimin e të rinjve në kuadër te Këshillit Veprimit Rinor Lokal në Deçan.

ANALIZA E NIVELIT TE ARSIMIT TË TË RINJËVE NE ZONAT RURALE JANAR-QERSHOR 2023

Meqenëse niveli i arsimit dhe pjesëmarrja e tyre në shkolla, sipas vlerësimit, është mjaft i ultë në zonat rurale atëherë është e domosdoshme në teren të mblidhen statistika dhe të rekomandohen institucionet arsimore dhe kulturore për mënyrën e ndikimit në zgjidhjen e këtij problemi. Pas analizave dhe mbledhjes se statistikave, po ashtu grupet e ndryshme rinore do të kenë mundësi që të krijojnë fokus-grupe, të cilat do të ishin pjesë e trajnimeve, seminareve, projekteve si dhe fokus-grupeve te ndryshme.

AKTIVIZIMI I KAMPEVE RINORE NE ZONAT RURALE 2023-2026

Pas analizave që do të duhet të bëhen në zonat rurale, është menduar qe ne këto zona të mbahen kampe të ndryshme me grupe të të rinjve të cilat do të jenë kampe të edukimit jo-formale me të cilat do të organizoheshin seminare dhe trajnime të ndryshme nga OJQ-të e Deçanit dhe jashtë saj, të përkrahur nga sektori i Rinisë.

JAVA E TË RINJEVE BASHKEATDHETARE

KVRL- do të organizojë javën e të rinjve bashkatdhetar në hapësirat e Qendrës Rinore, si një aktivitet vullnetar nga të rinjtë e komunës së Deçanit ku do të ketë aktivitete të ndryshme si : Njohja në mes veti , përgatitje te ushqimit tradicional, shkëmbim përvojash dhe ideve .

ORGANIZIMI I KURSEVE PERIODIKE NE FUSHA TE CAKTUARA

Si në mësimin e gjuhës angleze, kompjuterëve, gazetarisë, aktrimit , muzikës , artit, dhe hartimit te projekteve.(**2023-2026**)

KVRL me bashkëpunim me sektorin e Rinise si dhe Drejtorisë për Arsim do të organizojnë kurse të gjuhëve te huaja , dhe kurse te ndryshme si dhe për hartimin e projekteve për grupet jo formale që do të krijohen në fshatra.

RRJETIZIMI APO NËNDEGËT RINORE NË FSHATRA

Plani i veprimit rinor lokal do të jetë më i lehtë dhe i zbatueshëm me rrjetëzimin dhe krijimin e nëndegëve rinore në fshatrat e komunës së Deçanit të cilët do të jenë me afër aktiviteteve rinore në kuadër të KLVR. Për të zbatuar planin për Rini në zonat rurale është i domosdoshëm rrjetëzimi i grupeve jo-formale të të rinjtë nëpër fshatra, me kalimin e kohës këto grupe do të kishin mundur të jenë pjesë aktive edhe në proceset e vendimmarrjes.

MOTIVIMI I TË RINJEVE NE BIBLIOTEKA

Një ndër mënyrat e nxitjes së leximit janë menduar edhe biblioteka të vogla që të jenë funksionale nëpër fshatrat e komunës së Deçanit. Këto biblioteka do të mund të zbusnin analfabetizmin në mënyrë indirekte.

ORGANZIMI I LOJËRAVE PA KUFI-POPULLORE

Në të kaluarën lojërat popullore kanë qenë shumë atraktive dhe kanë qenë pjesë e largimit të të rinjve nga rruga. Këto lojëra do të mund të organizoheshin në pjesët rurale të komunës se Deçanit në koordinim të plot me sektorin e rinisë dhe sportit si dhe drejtorisë së shëndetësisë në komunën e Deçanit.

TË RINJËT NË VENDIMARRJE

Kuvendi vjetor i KVRL-së

Në kuadër të Kuvendit vjetor të KVRL-së të rinjtë do të mund të ishin të përfshirë në krijimin e mekanizmit rinor, siç është Këshilli Veprimit Rinor Lokal edhe do të zgjedhin përfaqësuesit e tyre në këtë mekanizëm këshillë dhënës për Kryetarin e Komunës.

TRYEZA-DEBATE MBI ROLIN E TË RINJËVE NË VENDIMMARRJE

Është e rëndësishme që të vazhdohet me ngritjen e vetëdijes për rolin dhe rëndësinë që ka shoqëria Deçanase, që të rinjtë të jenë pjesë e vendimmarrjes. Sidomos në fushat qe prekin jetën e tyre të përditshme, qoftë në institucionet edukative arsimore qoftë në institucionet tjera. Mbajta e këtyre tryezave do të mund të sillte rekomandime të shumta për institucionet lokale në mënyre që të jenë në hap me kohen për qasje ndaj rinisë Deçanase.

KONFERENCA DITORE – TË RINJËT NË VENDIMMARRJE

Konferenca ditore e të rinjve do të duhej të organizohej nga KVRL-ja, në të cilën do të merrnin pjesë edhe të rinjtë nga qytetet tjera dhe përfaqësues të institucioneve, me qëllim të shkëmbimit të praktikave të mira dhe efektive nga të gjithë. Këto konferenca do të sillnin edhe donatorë të ndryshëm në pjesëmarrje, në mënyrë që ata të shohin interesimin, organizimin dhe funksionimin e të rinjve të Deçanit.

DITA E TRASHIGIMISË KULTURORE DEÇAN

Ky projekt nënkupton organizimin kolektiv të grupeve të ndryshme rinore për të vizituar objektet kulturore, fetare, muzetë, vendet e veçanta historike siç është: Kompleksi Memorial "Dëshmoret e Kombit në Gllogjan" apo vendet tjera të interesit nacional qoftë brenda apo jashtë qytetit. Ky projekt bëhet me qëllim që të rinjtë apo të rejat e qytetit të Deçanit të njohin vendin dhe ambientin që i rrethon. Në kuadër të këtij projekti mund të ishin kyçur: Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport, dhe Drejtoria për Arsim dhe ajo e Ambientit si dhe organizatat tjera jo-qeveritare.

ELIMINIMI I BARRIERAVE ARKITEKTONIKE NË QENDRAT EDUKATIVO-

ARSIMORE PËR PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Në kuadër të kësaj politike është e domosdoshme që të ketë një angazhim më të madh nga drejtoritë përkatëse Komunale, që në qendrat edukative arsimore të ketë largim të barrierave arkitektonike, në mënyrë që personat me aftësi të kufizuar të kenë qasje shumë më të mirë.

FUSHATA E VETËDIJESIMIT PËR REGJISTRIM NË QENDRAT PËR PUNË

Një ndër projektet që do të duhej të ishin të vazhdueshme janë edhe fushata për regjistrim, të cilat janë të domosdoshme për të parë dhe identifikuar numrin e të rinjve që përfundojnë shkollën dhe janë të papunë. Këto fushata vetëdijesimi do të duhej të ishin bërë në zonat rurale dhe urbane.

ORGANIZIMI DHE KËSHILLIMI NË KARRIERË

Orientimi i hershëm për profesion, duke filluar qe nga shkolla fillore, meqë rast Drejtoria për Arsim do të mund të angazhonte një këshilltar apo më shumë këshillues të karrierës nëpërmjet Ministrisë së Arsimit.

ORGANIZIMI I TRAJNIMEVE PËR NDËRMARRËSI TË TË RINJËVE

Në kuadër të këtij aktiviteti do të mund të organizoheshin trajnime për nxitjen e bizneseve të vogla dhe të mesme duke u bazuar në idetë mbi biznes planet dhe idetë e të rinjve. Model ky i nxitjes së ndërmarrësve të të rinjve që aplikohet në BE.

STIMULIMI I TALENTEVE TË RINJ APO REJA

Organizimi i kuizeve të diturisë, krijimi i shoqërive kulturore artistike, krijimi i grupeve muzikore, prezantimi i këtyre vlerave etj.

Në kuadër të këtij projekti do të mund të hynin të rinjtë nga klasat e 9-ta deri tek ata që janë në Universitet. Këto kuize të diturisë do të nxirrnin talent në fusha të ndryshme dhe në fund fituesit do të stimuloheshin për kryerje të kurseve ose edhe për dhënie të bursave.

PANAIRI I SHKENCËS DHE KULTURËS

Qëllimi i këtij panairi është që nxënësit e shkollave të mesme të prezantojnë talentin e tyre duke promovuar të arriturat në mësim-nxënie.

TALENTET NË SPORT

Projekti talentet në sport do të fus mekanizmin e marrëveshjeve me klube sportive dhe shkolla të sportit përmes Drejtorisë së Kulturës Rinis dhe Sporteve si dhe Drejtorisë së Arsimit, që të rinjtë të bëhen anëtarë të klubeve që nga shkollat e tyre.

9 MAJI DITA E EVROPËS

Festimi i ditës së Evropës përmes aktiviteteve gjithëpërfshirëse rinore, me partneritet të plotë në mes të sektorit të rinisë, KVRL-së , organizatave të rinisë si dhe partnereve të tjerë të cilët do të stimulonin njohurit për bashkimin Evropian dhe nxjerrjen e kualiteteve mbi këto njohuri.

EDUKIMI SHËNDETËSOR DHE PARANDALIMI I DUKURIVE NEGATIVE

Projektet në kuadër të kësaj politike do të duhej të ishin të lidhura me shënimin e datave ndërkombëtare siç janë:

- ***24* Marsi dita e Evropiane e Parqeve**

Në kuadër të kësaj date, do të udhëheqshin fushata vetëdijesimi nëpërmes këshillave rinor të shkollave të mesme, për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e parqeve si dhe për pengimin dhe shkatërrimin e tyre.

- ***31-* MAJI DITA NDËRKOMBËTARE KUNDËR DUHANIT**

Ky projekt në koordinim të plotë me Drejtorinë e Shëndetësisë, do të jepte mundësinë e organizimit të debateve dhe tryezave të ndryshme kundër duhanit por edhe do të jepnin mundësinë e zbatimit të ligjit kundër duhanit.

- **28 QESHORI DITA KUNDËR NARKOTIKËVE**

Në këtë ditë me organizime dhe seminare të ndryshme do të mund të ngrihej vetëdija për pasojat që sjell narkomania dhe në të njëjtën kohë do të mund të merreshin më shume udhëzime mbi parandalimin të kësaj dukurie.

- **1 DHJETORI DITA NDËRKOMBËTARE KUNDËR HIV-AIDS**

Në bashkëpunim me Institutin e Shëndetësisë publike dhe sektorin e Rinis do të organizohen debate në qytetin e Deçanit për të dhënë informacione dhe për të ngritur shkallen e vetëdijes tek të rinjtë për Hiv-Aids.

IDENTIFIKIMI DHE PARANDALIMI I DUKURIVE NEGATIVE NË SHKOLLA

Në kuadër të planit veprues mbi identifikimet dhe parandalimin e dukurive negative në shkolla, mendohet të organizohen takime, tryeza dhe debate mbi mundësinë dhe mënyrat e parandalimit për të njëjtën kohë edhe ofrimin e partneritetit si dhe përkujdesjes institucionale të të rinjve në shkolla.

MUAJI I RINISË- 17 SHTATORI

Muaj i rinisë është aktivitet tradicional, që organizohet nga Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport, me bashkëpunim me sektorët e Rinisë pranë Drejtorive përkatëse nëpër Komuna. Ky aktivitet tashmë tradicional organizohet në tërë Kosovën dhe ka karakter garues.
Qëllimi i Muajit të Rinisë është mobilizimi i të rinjve në tërë Kosovën në këtë rast edhe në Komunën tonë, rreth aktiviteteve të shumta që kanë për qëllim bashkëpunimi në mes të rinjve, sensibilizimi e opinionit për rolin e rëndësishëm të rinisë në shoqëri dhe përkushtimin e institucioneve dhe organizatave përkatëse ndaj rinisë.
Në kuadër të Muajit të Rinisë çdo qytet i Kosovës ka ditën e vet për organizimin e aktiviteteve kryesore. Dita e Rinisë në Komunën tonë është në Shtatori. Ky aktivitet organizohet me organizatat rinore dhe shoqëria civile.

ORGANIZIMI I SPORTIT DIMËROR (SKIJIM)

Ky aktivitet parashihen te organizohen në kompleksin e Alpeve Shqiptare prapa pushimores se fëmijëve ku të rinjët Deçanas mund te tregojnë talentin e tyre ne skijim.

GARA NE CIKLIZEM

Këto gara parashihen te organizohen ne pjesët rurale te Deçanit, këto gara do te kenë karakter garues komunal.

SHFAQJET TEATRALE

Duke marre parasysh nevojën e madhe per art nga qytetaret e Deçanit e kemi parë te arsyeshme që të kemi një pjesë të artit në Komunen e Deçanit, ku do te ketë shfaqje të ndryshme teatrale.

EVENIMENTET OSE NGJARJET

Me evinimente është paraparë që do të zhvillohen ngjarje të ndryshme në kohë të pacaktuar me plan të KVRL-s dhe me kërkesa të veçanta nga të rinjtë.

17 SHKURTI

Me rastin e Ditës së Pavarësisë së Kosovës KVRL do te organizoj në palestrën e Gjimnazit "Vëllezërit Frashëri", të sportit Futsall me karakter Komunal.

16 QERSHORI

Me rastin e 16 Qershorit Ditës se Çlirimit të Deçanit KVRL ne bashkëpunim me grupet vullnetare do të organizoj aktivitete kulturore-sportive.

DITA E STUDENTËVE

Me këtë eveniment është paraparë që të jetë një ditë e veçantë me studentët e Komunës së Deçanit dhe ku do të ketë njohje në mes studentëve dhe të ketë shkëmbim idesh ne mes tyre.

BUXHETI I PARAPARË PËR ZBATIMIN E AKTIVITETEVE TË PARAPARA

Objektivat e Politikes	Aktiviteti	Rezultatet e pritshme	Institucionet përgjegjëse	Institucionet partnere	Afati kohor			Buxheti
	Fuqizimi i qendrës rinore	Krijimi kushteve elementare me dy përgjegjës aktiv me orar te shkurtuar kater ore ne dite me pag mujore 125€ per person	DKRS	MKRS dhe partner te ndryshëm	2023 500	2024 1700	2025 1700	3900€
	12 Gushti dita Ndërkombëtarë e Rinisë	Promovimi i vlerave kulturore-sportive	DKRS	OJQ-të	400	400	400	1200€
	Shërbimi për paqe (organizimi i kampanjave për dhurimin e gjakut dhe aktivitete solidarizuese	Promovimi i punës vullnetare me grupe multietnike ne qytet	Sektori i Rinise	DSHMS,OJQ		250	250	500€
	Aktivitet kulturore, gara të ndryshme në pikturë, art, muzikë, etj.	Promovimi i vlerave multietnike me karakter garues	Sektori i Rinise	DASH, OJQ,MKRS		400	400	800€
	Shënimi i ditës ndërkombëtare te ambientit	Promovimi i rëndësisë se ruajtjes se ambientit, pastrimi i qytetit	Drejtori e Ambientit dhe arsimit dhe partner te tjerë	DKRS, dhe OJQ dhe grupet vullnetare		250	250	500€

	Seminaret	Nxjerrja e nevojave plotësuese për te rinjtë si dhe marrja e ideve për plotësimin e PVRL	DKRS	MKRS, OJQ		300	300	600€
	Analiza e nivelit të Arsimit të të rinjve në zonat rurale.	Mbledhja e të dhënave të sakta mbi gjendjen e shkollimit të të rinjve në zonat rurale.	DASH	DKRS,OJQ	200	200	200	600€
	Kampet rinore tre ditore.	Përmirësimi i gjendjes se te rinjve ne zonat rurale	DKRS	Grupet jo formale në zonat rurale , OJQ-të		500	500	1000€
	Organizimi i Kurseve të Gjuhës Angleze , Kompjuterëve ,dhe Hartimin e Projekteve.	Ngritje e nivelit të rinjve në Zonat Rurale në këto fusha	DASH	DKRS MASHT		1200	1200	2400€
	Themelimi i grupeve jo formale të të rinjve në zonat rurale.	Aktivizimi i të rinjve në mënyrë të organizuar	DKRS	OJQ-të rinore	0	0	0	0
	Motivimi i të rinjve në biblioteka	Ofrimi me librin dhe nxitja për arsimime përmes këtyre bibliotekave	DASH	MASHT, Biblioteka nder-komunale dhe donator tjerë .	200	200	200	600€
Organizimi i lojërave popullore në fshatra.	**Aktivizimi i rinis që të jenë aktiv dhe ringjallja e lojërave tradicionale .**	Sektori i Rinisë dhe Sportit.	Klubet e ndryshme sportive OJQ-ve			500	500	1000€

ivendi Vjetor i .VR-së	**Zgjedhja e organeve Drejtuese,dhe raportimi i punës një vjeçare të KLVR-së**	Organet drejtuese të KVRL-së	DKRS MKRS		300	300	600€
yezë ,debate roli i isë në vendim arrje	**Nxjerrja e rekomandimeve mbi mundësinë e rinisë dhe rolin e tyre në vendim marrje.**	DKRS	KVRL		350	350	700€

nferenca ditore e rinjtë në Vendim arrje.	**Nxjerrja e mënyrave të bashkëpunimit, nder-komunal për forcimin e rinisë.**	KVRL	DKRS	450	450	450	1350€
:a e Trashëgimisë lturore në Deçan	**Promovimi i vlerave Historike,kulturore,të trashëgimisë si dhe atyre fetare përmes vizitave të organizuara,me ciceron.**	DKRS	MKRS KVRL	350	350	350	1050€
minimi i rrierave kitektonike në ndrat edukativo - simore	**Lehtësimi i qarkullimit për persona me aftësi të Kufizuara.**	Drejtoria për Urbanizëm dhe planifikim Hapsinor	Bizneset dhe Handikos	0	0	0	0€
shata e tëdijesimit për gjistrimin në entin r punësim(ZKP)	**Rritja e të regjistruarve në qendra.**	Enti për Punësim	DSHMS, OJQ-të		150	150	300€

Panairi i Shkencës dhe Kulturës	**Nxjerrja e talenteve të rinj duke promovuar të arriturat me mësimnxënie**	DASH, DKRS	KVRL ,Grupet Vullnetare		400	400	800€
Talentet në Sporte	**Ngritja e bashkëpunimit në mes të klubeve sportive,organizata të rinjve ,Sektori i Sportit**	DKRS	Klubet Sportive,KVRL	400	400	400	1200€
Dita e Evropës 9 Maj	**Nxitja e të rinjve për njohuritë për Bashkimin Evropian dhe shënimi i kësaj date.**	DKRS	Zyra e Bashkimit Evropian		500	500	1000€

Java e maturantëve	**Aktivitete kulturoro – argëtuese**	KVRL	Këshillat e nxënësve të shkollave të mesme	4500	450	450	1350€
24 Marsi dita evropiane e parqeve	**Ngritja e nivelit të vetëdijes tek të rinjtë për rëndësinë e ruajtjes së parqeve si dhe për efektin e tyre në shëndetin e njeriut.**	DAPH	DKRS,KVRL, Grupet Vullnetare.		500	500	1000€

31 Maji dita ndërkombëtare kundër Duhanit.	**Rritja e nivelit të njohurive tek të rinjtë mbi dëmet e përdorimit të duhanit dhe rrezikun që sjell tek njeriu.**	DSHMS	MKRS,KVRL Grupet Vullnetare		500	500	1000€
28 Qershori dita ndërkombëtare kundër narkotikëve.	**Rritja e nivelit të njohurive tek të rinjtë mbi dëmet e përdorimit të narkotikëve,si dhe mënyra e parandalimit të kësaj dukurie**	DKRS	DSHMS,MKRS KVRL, Grupet Vullnetare	f	400	400	800€
1 Dhjetori dita ndërkombëtare kundër HIV-AIDS-it	**Përmes shënimit të kësaj date do të presim që niveli i njohurive tek të rinjtë dhe mënyra e parandalimit të kësaj sëmundje të rritet.**	MKRS	DSHMS	500	500	500	1500€
Tryeza me temën dukuritë negative në shkolla dhe mënyra e parandalimit.	**Përmes këtyre tryezave do të dëgjohet zëri i nxënësve të mesëm lidhur me dukuritë negative.**	DASH	MASHT KVRL	300	300	300	900€
Muaji i Rinisë	**Mobilizimi i Rinisë , Bashkëpunimi në mes veti si dhe promovimi i rolit te rinisë në Shoqëri**	DKRS, MKRS	KVRL,Grupet Vullnetare	600	600	600	1800€
Organizimi i sportit dimëror (skijim)	Aktivizimi i te rinjeve ne kete sport atraktiv	DKRS KVRL	Grupet vullnetare		300	300	600€
Gara ne ciklizem	Mobilizimi i te rinjeve per sporte atraktive	DKRS Federata per ciklizem	KVRL Grupet vullnetare OJQ-te		600	600	1000€
Shfaqje teatrale	Mobilizimi i te rinjeve per artin	DKRS	Teatrot lokale etj.		1000	1000	2000€
Evenimentet Ose ngjarjet	Organizime te ndryshme si festivale Koncerte et.	DKRS KVRL	OJQ-te Gr upet vullnetare				Shuma sipas kerkeses

17 Shkurti	Aktivitete sportive me karakter Komunal	DKRS	KVRL OJQ-te Grupet vullnetare		900	900	1800€
Dita e Studenteve	Njohja e studenteve ne mes veti.	KVRL	OJQ-t studentore		450	450	900€
Pagesa per stimulim te strukturave KVRL-se	Pages e cila do te ndahet nga Kryetari i KVRL-se	KVRL	KVRL	1000	1000	1000	3000€
Shuma e përgjithshme e buxhetit për PVRL-në							**Total: 36.850€**

01.Nr.VIII-3 ,
Deçan,dt.28.09.2023

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ

Në mbështetje të nenit 11 dhe nenit 12, paragrafi 2, pika c), të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008, 04 Qershor 2008), të Kreut II dhe Kreut III të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 27/2008, 03 Qershor 2008), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L-108 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2016, 03 Gusht 2018), nenit 26 pika 10 të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, dt.31.10.2019, **Kuvendi i Komunës së Deçanit pasi Rishqyrtoi Vendimin 01.Nr.VII-5, për miratimin e Rregullores për Taksat Komunale, të miratuar me dt.31.07.2023, me Rekomandim të Ministrisë së Punëve të Brendshme të dt.06.09.2023, Nr.268, me rekomandim të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, të Minitrisë së Shëndetësisë dhe të Ministrisë së Drejtësisë,** Kuvendi i Komunës së Deçanit, në mbledhjen e mbajtur më dt.28.09.2023, merr këtë:

V E N D I M
Për miratimin e Rregullores për Taksat Komunale

Neni 1

Me këtë Vendim miratohet Rregullorja për taksat Komunale, për Komunën e Deçanit (sipas rekomandimeve të Ministrive).

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është akti komunal me emërtimin, Rregullorja për taksat Komunale, për Komunën e Deçanit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Zyra e Kryetarit në bashkëpunim me të gjitha Drejtoritë e Komunës së Deçanit.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

01.Nr.VIII-7
Deçan,dt.28.09.2023

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ

K.K.Deçan AS 34612
01 06.10.23